



UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues
Dr. sc. Sabri Sadiku

Nr. Prot. 1285
Dt 27 09 2018

Në bazë të nenit 6, pika 1, të Rregullores mbi punën e Këshillit Drejtues, thërras mbledhjen e XXXV të Këshillit Drejtues të Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini" dhe propozoj këtë:

REND DITE

1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes XXXIV të mbajtur më 17.09.2018.
2. Informim i rektorit për rrjedhat në UMIB gjatë periudhës midis dy mbledhjeve të KD-së.
3. Shqyrtimi dhe marrja e vendimit lidhur me kërkesat drejtuar KD-së:
 - Kërkesë nga prof. aso. dr. Milaim Sadiku për gjetjen e mundësisë së pagesës dhe mbajtjes së 6 orëve mësim në javë për profesorët nga Shqipëria që mbajnë mësim në FTU.
4. Të ndryshme.

Mbledhja do të mbahet të hënën, më 27.09.2018, në orën 13:00.

Kryesuesi Këshillit Drejtues
Dr. sc. Sabri Sadiku





UNIVERSITETI I MITROVICËS
UNIVERSITY OF MITROVICA
"ISA BOLETINI"

PIM Trepça, 40 000 Mitrovicë, Republika e Kosovës
<http://www.umib.net>; Tel: +381-28535725/535727

Kryesues i Këshillit Drejtues
Dr. sc. Sabri Sadiku

Nr. Prot. 1293
Datë 28.09.2018

Këshilli Drejtues i Universitetit të Mitrovicës "Isa Boletini", në mbledhjen e mbajtur më 27.09.2018, mori:

VENDIM

- I. Përfundimisht nga neni 5, pika 4.5, i Rregullores për të ardhura personale të UMIB-it, personelit akademik nga Shqipëria të angazhuar në cilësinë e bashkëpunësorëve të jashtëm në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore u lejohet që të mbajnë deri në 6 orë ligjërata në javë, por jo më shumë se fondi i orëve të përcaktuara për semestër, respektivisht për vit akademik.
- II. Personeli nga pika I e këtij vendimi janë:
 1. Prof. asoc. dr. Ilirjan Malollari
 2. Prof. dr. Bizena Bijó
 3. Prof. dr. Rozana Troja
 4. Prof. dr. Mirela Lika dhe
 5. Prof. asoc. dr. Rozeta Hasalliu.
- III. Obligohet Zyra për çështje akademik dhe Dekanati i FTU-së për zbatimin e këtij vendimi.
- IV. Ky vendim vlen vetëm për vitin akademik 2018/2019.
- V. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Arsyetim

Këshilli Drejtues, pas shqyrtimit të kërkesës së prof. asoc. dr. Milaim Sadiku, dekan i FTU-së për lejimin e mbajtjes deri në 6 orë ligjërata në javë, por jo më shumë se fondi i orëve të përcaktuara për semestër, respektivisht për vit akademik për personelin akademik nga Shqipëria të angazhuar në cilësinë e bashkëpunësorëve të jashtëm në Fakultetin e Teknologjisë Ushqimore, e konsideroi të arsyeshëm kërkesën, për arsye se në disa prej lëndëve fondi i orëve është 3 orë në javë, dmth 12 orë në muaj. Nga dy ardhjet e tyre sipas kontratës mbahen 10 orë mësim, ndërsa ardhja e tretë vetëm për dy orë po paraqet vështirësi si për ta, ashtu edhe për studentët si dhe për fakultetin për organizimin e mësimin. Bazuar në këtë që u cek më lartë, Këshilli Drejtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UMIB-it,
2. Fakultetit,
3. Zyrës për çështje akademike UMIB
5. Shërbimi financiar,
6. Zyrës së personelit
3. Zyrtarit Ligjor.

Dr. sc. Sabri Sadiku

Kryesues i Këshillit Drejtues

